



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

Këshilli Drejtues I Odës së Stomatologëve të Kosovës, në mbështetje të nenit 8 dhe 40 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësore nr 04/L-150, në mbledhjen e mbajtur me 29/10/2019 nxjerr këtë :

V E N D I M

- I. Të gjithë stomatologët të licencuar në vitet 2015- 16 shtator 2016 të cilët janë licencuar në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, janë të obliguar që detyrimin ligjor mbi pagesën e anëtarësisë në OSK ta paguajnë nga viti 2019.
- II. Në rast të mos përmbushjes së këtij obligimi ligjor, OSK është e detyruar që ndaj kësaj kategorie të stomatologëve të ndërmarrë masa disiplinore konform nenit 40, paragrafi 2 të Ligjit për Odën e Profesionistëve Shëndetësor.
- III. Obligohet shërbimi profesional i OSK-së t'i përgadisë listat e stomatologëve nga paragrafi i I-rë i këtij vendimi për Komisionin për Regjistrim, Licencim/Rilicencim të Stomatologëve.
- IV. Obligohet Komisioni për Regjistrim, Licencim/Rilicencim të Stomatologëve në zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

Arsyetim

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 29/10/2019 ka shqyrtuar listën e anëtarësisë nga Databaza e krijuar dhe përkundër ftesave publike në Webfaqen zyrtare të OSK-së, të bërë me datën 11 dhe 31 Korrik 2019 për anëtarësim në OSK, një pjesë e stomatologëve të kësaj

kategorie nuk janë përgjegjur këtij detyrimi ligjor. Këshilli Drejtues duke pasur parasysh nenin 8 të Ligjit për Odën e Profesionistëve Shëndetësor nr 04/L-150 “Anëtarësimi në Oda është i detyrueshëm për të gjithë doktorët e mjekësisë, doktorët e stomatologjisë, farmacistët e diplomuar, infermierët e diplomuar, mamitë e diplomuara, fizioterapeutët e diplomuar, laborantët e lartë mjekësor, logopedët e diplomuar, foniatët e diplomuar, psikologët klinik, profesionistët tjerë shëndetësor me kualifikim të mesëm dhe të lartë të përcaktuar në regjistrin zyrtar të ministrisë të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre shëndetësore në Republikën e Kosovës.” dhe nenin 40 “Anëtarët e Odës kanë obligim që në mënyrë të rregullt të paguajnë anëtarësinë, kompensimin për regjistrim, licencim dhe shërbime të tjera administrative në pajtim me ligjin dhe aktet tjera normative të Odës “ vendosi që të gjithë stomatologët e licencuar nga viti 2015 – 16 shtator 2016 që obligimi mbi pagesën e anëtarësisë në OSK t’ju rrjedh nga viti 2019.

Prandaj, duke u bazuar në këtë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

P’dergohet:

- Komisionit për Licencim
- Shërbimit Profesional
- Për publikim në web



Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof.Dr. Blerim Kamberi